

VENDIM
Nr. 58, datë 3.2.2017

**PËR NGRITJEN, NË SHQIPËRI, TË QENDRËS SË EKSELENCËS SË NATO-s PËR
STUDIMIN E FENOMENIT TË LUFTËTARËVE TË HUAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen, në Shqipëri, të Qendrës së Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj (NATO Center of Excellence for Foreign Fighters – NATO CoE FF).

2. Qendra e Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj do të ushtrojë aktivitetin brenda garnizonit “Skënderbej”. Ministria e Mbrojtjes siguron pajisjet dhe të gjithë mbështetjen logjistike të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë dhe për funksionimin e qendrës.

3. Qendra e Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj është institucion qendror, në varësi të ministrit të Mbrojtjes, dhe ka personalitet juridik publik.

4. Misioni i Qendrës së Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj, në Shqipëri, është kontributi në fushën studimore dhe edukuese për informimin e vendimmarrësve, në nivel kombëtar, dhe përgatitjen e punonjësve civilë e ushtarakë të agjencive të inteligjencës, ato të zbatimit të ligjit dhe personelit që angazhohet në operacionet ushtarake të drejuara nga NATO-ja për fenomenin e angazhimit të luftëtarëve të huaj në konfliktet aktuale dhe ato të ardhshme në rajon e më gjerë. Kjo qendër ekselence do të kontribuojë në njohjen, parandalimin dhe reduktimin e mundshëm të këtij fenomeni si dhe në rritjen e nivelit të përgatitjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe atyre të NATO-s në luftën kundër këtij fenomeni në operacionet ku ato janë të angazhuara.

5. Funksionet administrative që do të kryejë Qendra e Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj, në Shqipëri, janë:

- Kontributi në fushën studimore dhe edukuese për informimin e vendimmarrësve në nivel kombëtar;
- Përgatitja e punonjësve civilë dhe ushtarakë të agjencive të inteligjencës, agjencive të zbatimit të ligjit dhe personelit që angazhohet në operacionet ushtarake, të drejuara nga NATO-ja, për fenomenin e angazhimit të luftëtarëve të huaj në konfliktet aktuale dhe ato të ardhshme në rajon e më gjerë;
- Kontributi për njohjen, parandalimin dhe reduktimin e mundshëm të këtij fenomeni;
- Kontributi për rritjen e nivelit të përgatitjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe atyre të NATO-s në luftën kundër këtij fenomeni, në operacionet ku ato janë të angazhuara;
- Koordinimi i të gjithë procesit dhe ndjekja e procedurave për akreditimin e qendrës;
- Përgatitja e projektakteve të nevojshme për plotësimin e të gjithë kuadrit ligjor;
- Hartimi dhe negocimi i memorandumëve të mirëkuptimit, memorandumëve operacionale dhe funksionale, marrëveshjeve teknike, për funksionimin e qendrës dhe anëtarësimin në të të vendeve të tjera aleate/partnere.

6. Struktura dhe organika e Qendrës së Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj, në Shqipëri, miratohet nga Kryeministri.

7. Personeli i Qendrës së Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj, në Shqipëri, do të jetë ushtarak dhe civil. Marrëdhëniet e punës të personelit civil do të rregullohen në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

9. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi